sistemin e informimit publik;

të drejtën e shoqërimit të qytetarëve dhe organizimin politik;

të drejtën e zgjedhjes dhe mënyrën e zgjedhjes së

deputetëve, presidentit të republikës së Maqedonisë,

anëtarëve të këshillave dhe kryetarëve të komunave;

referendumin;

avokatin e popullit;

Kishën Ortodokse Maqedonase dhe Bashkësinë Fetare

Islame në Maqedoni, Kishën Katolike, Kishën

Evangjeliste-Methodiste dhe bashkësitë e tjera fetare dhe

grupet fetare;

dekorimet, mirënjohjet dhe shpërblimet;

festat në Republikën e Maqedonisë;

organizimin e administratës shtetërore;

të drejtën e përdorimit të gjuhëve dhe alfabeteve të bashkësive;

garantimin e mbrojtjes së identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të bashkësive dhe

çështjet e tjera që kanë të bëjnë me sistemin politik dhe marrëdhëniet midis bashkësive

### **3. Komisioni Anketues i Vazhdueshëm për Mbrojtjen e Lirive dhe të drejtave të Qytetarit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë**

Komisioni ka president dhe tetë anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

Komisioni i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me:

çështjet parimore, propozimet dhe mendimet në lidhje me realizimin e dispozitave të Kushtetutës, ligjeve dhe dispozitave dhe akteve të tjera me rëndësi për realizimin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarit;

shfaqjen e nevojës për miratimin e ligjeve dhe dispozitave dhe akteve të tjera për mbrojtjen më të plotë të lirive dhe të drejtave të qytetarëve;

ndjekjen, shqyrtimin dhe analizimin e realizimit të akteve

lirive dhe të drejtave të qytetarit;

shqyrtimin e shkresave të qytetarëve dhe dhënien e qëndrimeve në lidhje me to;

bashkëpunimin me organizatat shkencore dhe profesionale nga fusha e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarit; bashkëpunimin me organet e huaja dhe ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarit dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e qytetarit.

Komisioni nuk mund të kryejë funksione hetimore apo të tjera gjyqësore. Përfundimet e Komisionit janë bazë për vendosjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive të mbartësve të funksioneve publike.

### **Si rrjedh procedura e komunikimit me përfaqësues të bashkësisë me Komisionin?**

në Arkivin e Kuvendit të RM-së. Shqyrtimin paraeliminues të ankesës e kryen këshilltari i Komisionit. Nëse ai vlerëson se ka bazë që ankesa të shqyrtohet prej Komisionit, ajo do të vihet në rend të ditës në një prej seancave të ardhshme. Që diskutimi të jetë komplet, ndërkohë, Komisioni dërgon shkresë tek organi kompetent (ministria kompetente, gjykata kompetente, këshilli gjyqësor republikan etj.) me lutje që ta informojë për bazën e thënies në ankesën konkrete. Midis të tjerash, informacionet e organeve kompetente janë të domosdoshme për përcaktimin e të dhënave të Komisionit, të cilat, përsëri, nga ana e vet, janë bazë për vendosjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive të mbartësve të funksioneve publike.

### **Çfarë mban ankesa drejtuar Komisionit Anketues të Vazhdueshëm në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë?**

Ankesa që i drejtohet këtij komisioni nuk ka formë të përcaktuar rreptësisht, dhe as duhet të dorëzohet në ndonjë lloj formulari të përcaktuar paraprakisht. Megjithatë, që të trajtohet si e tërësishme, duhet t'i përmbajë të paktën elementët në bazë të

dimi real apo eventual të lirisë apo të drejtave bëhet fjalë:

- të dhëna për lëndimin real apo eventual;
- shtesa/dëshmi që mund ta mbështesin atë në çdo mënyrë të mundshme;
- të dhëna themelore për parashtresit e ankesës;

Komisioni ka obligim të përgjigjet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin në të cilin i është drejtuar dorëzuesi i ankesës – përfaqësues i bashkësisë konkrete në RM.

#### **4. Institucioni – Avokati i Popullit**

Çfarë mund të kryejë Avokati i Popullit kur konstaton se janë lënduar të drejtat e qytetarit – dorëzuesit prej organeve:

Në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit, avokati i popullit mund<sup>10</sup>:

të japë rekomandime, propozime, mendime dhe thënie në lidhje me mënyrën e anashkalimit të lëndimeve të konstatuara (rekomandim jep kur me siguri është vërtetuar se bëhet fjalë për shkelje të të drejtave me aktin apo veprimin konkret, kurse mendim jep kur vlerëson se nevojitet ndryshim apo plotësim i aktit të përgjithshëm të organit apo organizatës. Thëniet jepen në rastin kur nga gjendja faktike del se me vazhdimin e një sjelljeje të caktuar të organit apo organizatës do të cenohen të drejtat e dorëzuesit të anketës);

siguron mbrojtje të veçantë të fëmijëve, personave me nevoja të veçanta, personave që janë lëndë e torturës dhe tjetër lloj i sjelljes të egër, jonjerëzore dhe ofenduese apo dënimit në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes

të propozojë përsëritjen e procedurës së caktuar në përputhje me ligjin, nëse janë mbushur kushtet ligjore për përsëritje apo ripërtëritje të procedurës me kërkesë të palës apo edhe nëse ka bazë për ndryshimin e aktit administrativ sipas detyrës zyrtare;

të ngrejë iniciativë për vendosjen e procedurës disiplinore

---

<sup>10</sup> Ligji për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 60/2003 dhe 114/2009)

ndaj personit zyrtar apo përgjegjës, kur vlerëson se me veprimin e tij, përkatësisht me mosveprimin ka bazë për dyshim se ka shkelur detyrën zyrtare apo të punës;

të ngrëjë kërkesë tek prokurori publik kompetent për vërtetimin e përgjegjësisë penale nëse vlerëson se ekziston dyshim i bazuar për shkelje apo vepër penale të kryer të parapara me ligj;

të kërkojë shtyrje të zbatimit të aktit drejtues deri në vendimin e organit të shkallës së dytë apo deri në marrjen e vendimit nga gjykata kompetente, nëse konstaton shkelje të të drejtave, kurse zbatimi i aktit drejtues do të shkaktonte dëm të pakompe-sueshëm për ndonjë prej palëve në problem;

të formojë sektorë të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta, sektor për mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi, tortura apo lloj tjetër veprimi apo dënimi të egër, jonjerëzor dhe ofendues si dhe sektor për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të qytetarëve.

### **Si mund të veprojë Avokati i Popullit gjatë ndjekjes së gjendjeve për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të përfaqësuesve të bashkësive?**

pas ankesave të dorëzuara;

me iniciativë personale nëse në cilëndo mënyrë ka njohuri se nuk respektohen këto parime;

në bazë të mbikëqyrjeve të drejtpërdrejta të kryera në organe, organizata dhe institucione;

me ndjekjen e obligimeve programore të parapara të organeve dhe organizatave;

me ndjekjen e shpalljeve për vende të reja pune në organet dhe



organizatat që janë të detyruara t'i respektojnë parimet e dhëna kushtetuese.

Për sigurimin dhe respektimin e të drejtave ligjore dhe kushtetuese dhe parimeve për mosdiskriminim dhe përfaqësim adekuat dhe të drejtë të përfaqësuesve të bashkësive, Avokati i Popullit mundet me iniciativën e vet të japë udhëzime, mendime dhe kritika për organet para të cilave është kompetent të veprojë nëse vlerëson se me aktet e veçanta të përgjithshme dhe të mëvetësishme, me ndërmarrjen apo mosndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara nga organet apo organizatat e dhëna nuk respektohen apo nuk krijohen mekanizma juridikë për respektimin dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve dhe për realizimin e parimeve të dhëna në raport me përfaqësuesit e bashkësive.

### **Çfarë mund të bëjë Avokati i Popullit pas marrjes së ankesës<sup>11</sup> :**

#### **Avokati i Popullit mund të vendosë:**

të mos ngrejë procedurë apo të mos e shqyrtojë ankesën nëse është anonime, nuk është dorëzuar në afatin e caktuar ose nëse është keqpërdorimi të drejtës së ankesës, por është i obliguar në afat sa më të shkurtër ta informojë dorëzuesin, t'ia shpjegojë shkaqet për këtë dhe sipas mundësive ta këshillojë në cilën mënyrë ta realizojë të drejtën.

Avokati i Popullit e hedh poshtë ankesën nëse:

prej të dhënave që i ka në dorë del se nuk ka shkelje të lirive dhe të drejtave themelore të qytetarit;

ankesa nuk është complete dhe nëse dorëzuesi pas këshillimit paraprak prej avokatit të popullit nuk e ka plotësuar dhe për lëndën e ankesës është në vijim procedura gjyqësore.

<sup>11</sup> informacione të marra nga [www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk)

## **Avokati i popullit nuk ngre procedurë nëse:**

prej veprimtarisë apo prej vendimit të fundit të organit, përkatësisht organizatës ka kaluar më tepër se një vit, përveç se nëse vlerëson se iniciuesi e ka lëshuar afatin për shkaqe të caktuara. Nëse avokati i popullit vendos të ngrejë procedurë për këtë e lajmëron dorëzuesin e ankesës dhe organin, përkatësisht organizatën ndaj të cilës është ankesa.

## **Çfarë mund të bëjë Avokati i Popullit pas marrjes së ankesës:**

të kërkojë shpjegimet e nevojshme dhe informacione plotësuese prej organeve, përkatësisht organizatave për thëniet në ankesë;

të kryejë mbikëqyrje të drejtpërdrejtë në punët në kompetencat e organeve, përkatësisht organizatave;

të ftojë në bisedim funksionar zyrtar në organ, përkatësisht organizatë dhe çdo person tjetër, si dhe të kërkojë mendim prej institucioneve shkencore dhe profesionale.

## **Çfarë mund të bëjë Avokati i Popullit kur konstaton se dorëzuesit të ankesës i është shkelur ndonjë e drejtë ligjore apo kushtetuese:**

të propozojë organi, përkatësisht organizata të kryejë procedurë konkrete në përputhje me ligjin;

të dorëzojë kërkesë tek organi kompetent për vendosjen e problemit drejtues;

të dorëzojë kërkesë te organi, përkatësisht organizata për ndalim të përkohshëm të zbatimit të aktit;

të propozojë vendosje të procedurës disiplinore kundër personit zyrtar të organit, përkatësisht organizatës;

të dorëzojë kërkesë te prokuroria publike e përgjithshme për ngritjen e procedurës që të përcaktohet përgjegjësia penale apo për kundërvajtje;

të japë propozime për përmirësimin e punës dhe sjelljen e organeve, përkatësisht organizatave me palët.

Organet dhe organizatat janë të obliguara të veprojnë sipas propozimeve, mendimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe në afat jo më të madh se 30 ditë ta informojnë për masat dhe aktivitetet e ndërmarra sipas kërkesave të tij. Nëse organet dhe organizatat nuk veprojnë dhe nuk e informojnë Avokatin e Popullit për zbatimin e propozimeve dhe rekomandimeve të tij apo përsëri pjesërisht i pranojnë, Avokati i Popullit për këtë mund ta informojnë drejtpërdrejt organin më të lartë, ministrinë kompetente, Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, kurse me raport të veçantë ta informojnë edhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ose lëndën ta shpallë publikisht.

Personit zyrtari, i cili nuk do të veprojë sipas kërkesës së Avokatit të Popullit do t'i shqiptohet gjobë prej 500-1000 euro në vlerë denari.

Pasi Avokati i Popullit do ta përfundojë procedurën e informon dorëzuesin e ankesës.

### **Çfarë hyn në kategorinë e lëndimit të të drejtave kushtetuese dhe ligjore:**

sjellja burokratike, me vetëdashje, johumane dhe e turpshme, me qëllim apo pa, mos veprimi pas kërkesës së qytetarit, mosmarrja e aktit, vendimit përfundimit, mosdhënia



e vërtetimeve, dëshmime, mendimeve etj, shtyrja e procedurës, trajtimi jo i barabartë i qytetarëve, akti i miratuar gabimisht, akti i bazuar në gjendje aktive të gabueshme dhe të papërcaktuar plotësisht, akt i bazuar në material ligjor të gabueshëm, procedurë e lënduar dhe të gjitha sjelljet e tjera me qëllim apo jo dhe veprimet me të cilat thyhen të drejtat dhe liritë e qytetarit që garantohen me Kushtetutë, ligje dhe

## Avokati i Popullit sipas kompetencave vepron para:

### Qeverisë së Republikës së Maqedonisë:

- 1.shërbimeve;
- 2.komisioneve;
- 3.sekretariateve.

### Ministrive:

#### 1. Organet në përbërjen e ministrive:

**drejtori** (për kryerjen e sanksioneve, të punëve juridike të pronës, për doganat, për prodhimtarinë e qëllimshme, për të hyrat publike, për ekonominë e ujërave, për veterinarinë, për punët hidrometeorologjike, për lundrimin civil dhe ajror, për kadastrën dhe regjistrimin e pasurive të patundshme etj).

**inspektimet** (drejtuese, devizave, tregut, për inspektim teknik, për bujqësi, sanitet dhe shëndetësi, arsim, punë, për pushtetin lokal, për transport, ndërtim dhe urbanizëm, për mjedis jetësor dhe komunale)

**fonde** (për sigurim shëndetësor, për sigurim invalidor dhe të pensionit, për mjedis jetësor, për ujërat);

**ente** (i statistikës, i punëve gjeodezisë dhe të tjera);

**byro** (për hetime gjyqësore, për mbrojtje të pronësisë industriale, për

turizëm, për zhvillimin e arsimit, për zonat ekonomike të pazhvilluara mjaftueshëm, për mjekimet dhe të tjera);

**agjenci** (për diasporë, për informime, për sport dhe rininë, për zhvillim për investime);

**shërbime** (për mjedisin jetësor, për sistem informativ dhe hapësinor, për standardizim dhe meteorologji dhe të tjera);

**institucione shëndetësore** (spitale, ambulanca, spitale psikiatrike dhe nervo-psikiatrike, azile pleqsh dhe brefotrofë për fëmijë);

**institucione arsimore** (për moshën parashkollore, arsimin tetëvjeçar, të mesëm dhe të lartë);

**qendra për punë sociale** dhe të tjera

## 2. Njësitë rajonale

Avokati i Popullit intervenon në punën e ndërmarrjeve, shërbimeve dhe institucioneve publike nga fusha e: **hekurudhës, postës, telekomunikacioneve, ekonomisë, radios dhe televizionit, ndërmarrjeve komunale dhe banesore, si dhe në organet dhe trupat e pushtetit lokal.**

### **Sekretariati për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit**

Për zbatim me sukses të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, më 5.4.2002 u formua Sektori për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, i cili ndërkohë me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Qeverinë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 115/2007) u transformua në Sekretar-

në Janar të vitit 2008. Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë ka detyrë të zbatojë krejtësisht Marrëveshjen Kornizë të Ohrit dhe të sigurojë

mbështetje administrative dhe profesionale të zëvendëskryeminitrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i cili është i obliguar për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë.

Në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit janë miratuar një numër i madh i amendamenteve kushtetuese.

Këto amendamente përfshijnë: garantimin e statusit të gjuhës

bashkësive etnike në institucionet publike; statusin e bashkësive fetare; shprehjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të bashkësive etnike; procedurat e veçanta parlamentare për çështje me rëndësi të veçantë për bashkësitë etnike; decentralizimin e pushtetit. Në vitet e ardhshme legjislative e gjerë juridike do të miratohet. Me Amendamentet e Kushtetutës dhe ndryshimet juridike lidhur me to parimet e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit u bënë pjesë e sistemit juridik maqedonas. Themelimi i Sekretariatit për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit e thekson prioritetin që Qeveria maqedonase e vë zbatimit të principeve origjinale që janë vendosur në këtë Marrëveshje, që janë, ndërkohë, të siguruara me Kushtetutë dhe me ligje të tjera. Këto principe, së pari përfaqësimi i drejtë i bashkësive etnike në sektorin publik dhe decentralizim, janë me rëndësi të madhe për **stabilitetin** në vend, për **kohezionin** social, ndërtimin dhe mbrojtjen e një **shoqërie multietnike** të integruar. Në procesin e zbatimit të këtyre parimeve dhe përpjekje Sekretariat ka **funksion strategjik koordinues dhe monitorues**. Sido që të jetë Sekretariati nuk është organizata autonome dhe e izoluar që u shërben vetëm bashkësive dhe grupeve të veçanta. Ai është pjesë e makinerisë së Qeverisë së Maqedonisë që u shërben të gjithë qytetarëve në interesin publik.

## **Kompetencat e Sekretariatit**

Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë punon sidomos për:

Sigurim të koordinimit të organeve të administratës shtetërore për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë;

përgatitje të metodologjisë së marrjes së planeve aksionare në fushën e zbatimit të Marrëveshjes Kornizë;

Sigurim të resurseve njerëzore të nevojshme për realizimin e zbatimit të Marrëveshjes Kornizë;

Sigurim dhe realizim të mjeteve të nevojshme për zhvillim të suksesshëm të realizimit të obligimeve që dalin nga Marrëveshja Kornizë;

Përgatitje të raporteve për informimin e Qeverisë për nivelin e zbatimit të Marrëveshjes Kornizë;

Përgatitje të materialeve analitike-profesionale nga fusha e zbatimit të Marrëveshjes Kornizë;

E siguron dhe koordinon përpunimin e planit aksionar për përgatitjen e projekteve të Marrëveshjes Kornizë;

Sigurim të informimit të rregullt dhe në kohë të opinionit për procesin e zbatimit të Marrëveshjes Kornizë;

Monitorim i procesit të decentralizimit;

Sigurim të bashkëpunimit me trupat e jashtëm dhe me donatorët për realizimin e proceseve për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë;

Përforcim të bashkëpunimit me organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare dhe personat e tjerë juridikë;

Ndjekje të reformave në administratën publike në Republikën e Maqedonisë dhe në fushat e tjera të cilat direkt apo indirekt lidhen me zbatimin e Marrëveshjes Kornizë;

Analizë, ndjekje dhe koordinim të ligjeve të miratuara dhe ligjeve që do të miratohen dhe janë në lidhje të drejtpërdrejtë me Marrëveshjen Kornizë;

Ndjekje përmirësim të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë.



## Përfundim:

Të drejtat e qytetarëve që u takojnë bashkësive janë pjesë e korpusit të të drejtave dhe lirive universale të njeriut, por edhe koncept kualitativ i ndryshëm nga koncepti për barazi të të gjithëve dhe gjithkujt para Kushtetutës dhe ligjeve. Formulimi “të drejtat e qytetarëve që u takojnë bashkësive” që është në amendamentet e Kushtetutës të vitit 2001, është vazhdimëri e asaj të paraparë me Kushtetutën e vitit 1991 “të drejtat e përfaqësuesve të nacionaliteteve”, në kuptimin e theksimit të dimensionit individual mbi atë kolektiv të të drejtave të pakicave.

Sipas tyre, mbartës të të drejtave janë individë, kurse pjesa më e madhe e këtyre të dhënave mund të praktikohen në kolektiv, në interaksion me individët e tjerë që ndajnë milje identike kultu-

evropian për mbrojtjen e të drejtave të nacionaliteteve, amenda-

nas të shembullit të vetëm të shtetit shumëkulturore në rajonin më të gjerë. Qëllimi themelor i modelit maqedonas është ruajtja e integritetit të shtetit, dhe njëkohësisht ngritja e të drejtave të qytetarëve që u takojnë bashkësive në nivelin më të lartë, që e parashikojnë dokumentet ndërkombëtare relevante për mbrojtjen e të drejtave të njeriut/të pakicave.

## SHTOJCË I :

### BURIME JURIDIKE DHE LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Kushtetuta e RM-së
2. Amendamentet IV-XVIII të kushtetutës së RM-së  
(G. Zyrtare e RM-së 91/2001)
3. Ligji për Pushtetin Lokal  
(G. Zyrtare e RM-së.5/2002)
4. Ligji për Financim të Njësive të Pushtetit Lokal  
(G. Zyrtare e RM-së nr.61/04)
5. Ligji për Organizim Territorial të Pushtetit Lokal  
në Republikën e Maqedonisë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 55/04)
6. Ligji për Punë të Brendshme  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 92/2009)
7. Ligji për Nëpunësit Shtetërorë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 108/2005)
8. Kodi Zgjedhor  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 40/2006)
  
- Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në Njësitë  
e Pushtetit Lokal  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 101/2008)
  
10. Ligji për Dokumentet e Udhëtimit të shtetasve të  
Republikës së Maqedonisë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 73/04)

11. Ligji për Formimin e Universitetit Shtetëror në Tetovë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 8/04)
12. Ligji për Avokatin e Popullit
13. Ligji për Përdorimin e Flamujve të Bashkësive  
në Republikën e Maqedonisë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 58/05)
14. Ligji për Amnisti  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 18/02)
15. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 91/08)
16. Ligji për Arsimin Tetëvjeçar  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 52/02)
17. Ligji për Arsimin e Mesëm  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 44/95)
18. Ligji për Arsimin e Lartë
19. Ligji për Gjykatat  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 36/95)
20. Ligji për Zbatimin e Sanksioneve  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 2/06)
21. Ligji i Trashëgimisë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 47/96)
22. Ligji për Organizim dhe Punën e Organeve  
të Shërbimit Shtetëror  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 58/00)

23. Ligji për të Drejtat e Bashkësive Fetare  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 113/07)
24. Ligji për Veprimtarinë e radiodifuzionit  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 100/05)
25. Ligji për Kulturën  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 66/03)
26. Ligji për Procedurë Kontestimore  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 33/98)
27. Ligji për Procedurë Penale  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 15/97)
28. Ligji për Qeverinë  
(G. Zyrtare e RM-së nr. 115/2007)

## BURIME TË TJERA:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
3. Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKPK);
4. Deklarata për të Drejtat e Personave që u Takojnë Pakicave Nacionale apo Etnike, Fetare apo Gjuhësore
5. Pakti ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Qytetare;
6. Studim për të Drejtat e Personave që u Përkasin Pakicave Etnike, Add.1-7(1977)
7. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Rasor;
8. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (CEDAV);
9. Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
10. Rekomandimi Parlamentar i Këshillit të Evropës 1201(1993) të Protokollit Plotësues që e miratoi Asambleja më 1 shkurt 1993;
11. Dokument nga Konferenca e Kopenhagës për dimensionet njerëzore;
12. Dokument nga Konferenca e Helsinkit për nxitjen për Ndryshime

- 13.Rekomandimet e Hagës në lidhje me të drejtat e arsimit të pakicave kombëtare;
- 14.Rekomandimet e Lundit në lidhje me pjesëmarrjen efektive të pakicave kombëtare në jetën Publike;
- 15.Raport dhe rekomandime në lidhje me Romëve dhe Sintëve në rajonin e OSBE-së;
- 16.Drejtime për përdorim të gjuhëve të pakicave në emetimet në media;
- 17.Rekomandime për policinë në bashkësitë shumetnike
- 18.Marrëveshja Kornizë e Ohrit;
19. Ueb-faqja e Kuvendit të RM-së - [www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)
20. Ueb-Faqja e Kancelarisë së Avokatit të Popullit [www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk)
21. Ueb-faqja e Sekretariatit për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit [www.siofa.gov.mk](http://www.siofa.gov.mk)
- 22.Ueb-faqja e Shoqatës për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave në RM – ESE - [www.esem.org.mk](http://www.esem.org.mk)

## **INFORMACIONE PËR GJENDJET NË LIDHJE ME TË DREJTAT E NJERIUT**

### **Raporti i Human Rights Watch Report për vitin 2006**

– përmban të dhëna për tendencat zhvillimore të të drejtave të njeriut në mbi 60 vende në vitin 2005

Gjendet në këtë ueb-faqe:

[www.hrw.org/wr2k6/wr2006.pdf](http://www.hrw.org/wr2k6/wr2006.pdf)

lim përparimin e respektimit universal të të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.

Gjendet në këtë ueb-faqe:

[www.bookshop.eu.int/eGetRecords](http://www.bookshop.eu.int/eGetRecords)

**Të drejtat e njeriut në Azi dhe Paqësor (2004)** – Ky libër i përfshin temat si çlirimi nga tortura, liria e shprehjes, liria e botimit, të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtja e pakicave.

**Të drejtat e njeriut në Afrikë**

(2004) – Ky libër e shqyrton rolin e Organizatës për Bashkim Afrikan, tani Bashkimi Afrikan, dhe si ballafaqohet ajo me të drejtat e njeriut

**Forum për të drejtat e pakicave në OKB** – faqe interneti ku mund të gjenden të dhëna të dobishme në lidhje me pakicat.

Gjendet në këtë ueb-faqe:

[www.ohchr.org/minorityrights](http://www.ohchr.org/minorityrights)

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë:

[www.mhc.org.mk](http://www.mhc.org.mk)

Kancelaria e Avokatit të Popullit në RM

[www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk)



## **EDUKIM NGA FUSHA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË INTERNET**

**Baza e të dhënave për edukim dhe trajnim nga fusha e të drejtave të njeriut të Komesarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut:**

Gjendet në këtë ueb-faqe:  
[www.unhchr.ch/hredu.nsf](http://www.unhchr.ch/hredu.nsf)

Këshilli i Evropës:  
[www.coe.int](http://www.coe.int)

UNICEF:  
[www.unicef.org](http://www.unicef.org)

Partnerë për edukim në fushën e të drejtave të njeriut:  
[www.erc.hrea.org](http://www.erc.hrea.org)

Internet i të drejtave të njeriut:  
[www.hri.ca](http://www.hri.ca)

Programi për edukim në fushën e të drejtave të njeriut:  
[www.hrep.com.pk](http://www.hrep.com.pk)

Qendra Evropiane për Trajnim dhe Hulumtim të të Drejtave të Njeriut dhe Demokracisë:  
[www.etc-graz.at](http://www.etc-graz.at)

Kancelaria për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR):  
[www.osce.org/odihhr](http://www.osce.org/odihhr)

## SHTOJCA IV:

### **BIBLIOTEKA VIRTUALE**

**Instituti Austriak për të Drejtat e Njeriut:**

[www.2sbg.ac.at/home.htm](http://www.2sbg.ac.at/home.htm)

**Doracak konciz për të drejtat e njeriut në internet:**

[www.derechos.org/human-rights/manual.htm](http://www.derechos.org/human-rights/manual.htm)

**Portali i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:**

[www.cmiskp.echr.coe.int/tkp197/search.asp?skin=hudoc-en](http://www.cmiskp.echr.coe.int/tkp197/search.asp?skin=hudoc-en)

**Arkiva virtuale për të drejtat e njeriut projekti „DIANA“:**

[www.yale.edu/lawweb/Avalon/Diana/index.html](http://www.yale.edu/lawweb/Avalon/Diana/index.html)

**Biblioteka Evropiane:**

[www.theeuropeanlibrary.org/portal/index.htm](http://www.theeuropeanlibrary.org/portal/index.htm)

**Baza e të dhënave e OKB-së:**

[www.unp.un.org/online\\_online\\_databases.aspx](http://www.unp.un.org/online_online_databases.aspx)

**Biblioteka për të drejtat e njeriut e Universitetit të Minesotës:**

[www.umn.edu/humanrts](http://www.umn.edu/humanrts)

**Biblioteka e Institutit Raul Valenberg, Lund, Suedi:**

[www.rwi.lu.se/library](http://www.rwi.lu.se/library)

**Biblioteka virtuale Bayefsky:**

[www.bayefsky.com](http://www.bayefsky.com)

**Portali maqedonas për të drejtat e njeriut**

**(kryesisht për dokumentet ndërkombëtare dhe statusin e tyre):**

[www.covekovi-prava.gov.mk](http://www.covekovi-prava.gov.mk)